

## **Aktiviteti: Info day mbi platformën e punësimit online “GRADUA”.**

**Data:** 21.01.2020

**Vendi:** Salla “Silvano Pedrollo”

**Ora:** 10.00 – 11.00

### **Qëllimi:**

- të informonte mbi projektin Gradua dhe rëndësinë e tij të gjithë studentët e UPT, të cilët janë në prag diplomimi;
- të parashtronte rrugën e regjistrimit në platformë të studentëve të sapodiplomuar;
- të promovonte dhe udhëzonte studentët e sapodiplomuar për plotësimin e formularit të aplikimit;
- të udhëzonte studentët për të ndjekur në mënyrë aktive platformën, me qëllim që të krijojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë interaktive dhe të vazhduar me kompanitë, të cilat operojnë në fushën inxhinierike;

**Pjesëmarrës:** Në këtë aktivitet morën pjesë studentët të Bachelor-it, viti i III-të dhe studentët të Master-it nga gjithë fakultetet e UPT-së.

Në 21.01.2020, ora 10.00 në sallën “Silvano Pedrollo”, pranë Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës, u zhvillua Info Day mbi platformën e punësimit online GRADUA.

Dita e informimit u zhvillua në vijim të takimeve të drejtpërdrejta nëpër auditore, përkatësisht, në datat 14.01.2020 – 18.01.2020 që u kryen nga stafi i zyrës së këshillimit të karrierës.

### **Arritjet**

Gjatë informimit përveç realizimit të qëllimit që u vendosën rreth platformës Gradua, u ndoqën online dhe u shpjeguan në detaje të gjithë hapat nëpër të cilat kalon regjistrimi në platformë.

Në lidhje me ditën e informimit rreth platformës u publikua njoftimi për studentët edhe në faqen zyrtare të UPT.

Bashkëlidhur është:

1. Njoftimi në Web <http://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1049-njoftim-u-zhvillua-info-day-per-platfomen-e-punesimit-online-gradua>
2. Lista e pjesëmarrësve
3. Foto ilustruese nga aktiviteti

**14.01.2020 – 18.01.2020** Takime të drejtpërdrejta informuese me studentët të cdo fakulteti për të dhënë informacionin e nevojshëm në lidhje me platformën e punësimit online “GRADUA”.

